

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-198/11

Prishtinë, 3 tetor 2012

Në çështjen juridike të:

E.X.

Ankuesi

kundër

D.N.

Paraqitësi i kërkesës/Pala Përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, Elka Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, Anëtar, duke vendosur lidhur me ankesat kundër vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës: KPCC/D/A/92/2010 (lëndët janë të regjistruara në AKP me numrat: KPA23955, KPA23956, KPA23957, KPA23959, KPA23960, KPA23961, KPA23963, KPA23965, KPA23968, KPA23970, KPA23971, KPA23974 dhe KPA23977), i datës 28 tetor 2010, dhe KPCC/D/A/97/2010 (lëndët janë të regjistruara në AKP me numrat: KPA23958 dhe KPA23975), i datës 7 dhjetor 2010, pas shqyrtimit të mbajtur me 3 tetor 2012, mori këtë:

AKTGJYKIM

- 1- Ankesat e paraqitura nga E.X. me datë 9, 14 dhe 30 nëntor 2011 dhe të regjistruara me numrat GSK-KPA-A-198/11 deri GSK-KPA-A-205/11, GSK-KPA-A-211/11 deri GSK-KPA-A-216/11, dhe GSK-KPA-A-238/11, janë bashkuar në një lëndë të vetme me numër GSK-KPA-A-198/11.
- 2- Anulohen vendimet e Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës: KPCC/D/A/92/2010 (lëndët janë të regjistruara në AKP me numrat: KPA23955, KPA23956, KPA23957, KPA23959, KPA23960, KPA23961, KPA23963, KPA23965, KPA23968, KPA23970, KPA23971, KPA23974 and KPA23977), i datës 28 tetor 2010, dhe KPCC/D/A/97/2010 (lëndët janë të regjistruara në AKP me numrat KPA23958 dhe KPA23975), i datës 7 dhjetor 2010, të marra në mungesë të jurisdiksionit.
- 3- Hedhen posht kërkesat e paraqitura të D.N., nga Kragujevci R. e Sërbisë, KPA23955, KPA23956, KPA23957, KPA23958, KPA23959, KPA23960, KPA23961, KPA23963, KPA23965, KPA23968, KPA23970, KPA23971, KPA23974, KPA23975 dhe KPA23977, për shkak të mungesës së jurisdiksionit.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

Me 1 shkurt 2007, D.N. ka paraqitur 15 (pesëmbëdhjetë) kërkesa në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), duke kërkuar konfirmimin e së drejtës së pronësisë në disa ngastra dhe ri-posedimine tyre. Ai ka shpjeguar se këto ngastra kadastrale kanë qenë në emërin e tij dhe të cilat ishin uzurpuar.

Për ta mbështetur kërkesën e tij, ai ka paraqitur në AKP dokumentet si në vijim:

- Leternjoftimin, të lëshuar me datë 26 prill 2004, nga Komuna e Vitisë, Republika e Serbisë;
- Fleta Poseduese Nr. 4, lëshuar me datë 13 shkurt 1986, nga Drejtoria e Komunale e Përgjithshme e Komunës së Vitisë;
- Fleta Poseduese Nr. 4, lëshuar me 29 korrik 2004 nga Drejtorati për Kadastër, Gjoedezi dhe Pronë, Komuna e Vitisë, (UNMIK);

- Fleta Poseduese Nr. 134, lëshuar me 26 shkurt 2002 nga Institutit Republikan i Gjeodezisë në Prishtinë, Qendra Kadastrale Gjeodete, Komuna e Vitisë; dhe

Fletat Poseduese Nr. 4 dhe Nr. 134, konstatojnë se D.N. është pronar i ngastrave të kërkuara Komunën e Vitisë, Zona Kadastrale Sodovinë e Çerkezëve, si në vijim:

Numri i ankesës dhe dosjes së lëndës së AKP-së	Të dhënat lidhur me ngastrën e kërkuar
GSK-KPA-A-198/11 (KPA23961)	Ngastra Nr. 244, në vendin e quajtur “Svinjski Potok”, pemishte i klasës së 4-të, me sipërfaqe prej 0. 10. 50 ha
GSK-KPA-A-199/11 (KPA23977)	Ngastra Nr. 276, në vendin e quajtur “Svinjski Potok”, arë e klasës së 5-të, me sipërfaqe prej 1. 78. 86 ha
GSK-KPA-A-200/11 (KPA22974)	Ngastra Nr. 274, në vendin e quajtur “Svinjski Potok”, pemishte e klasës së 4-të, me sipërfaqe prej 0. 13. 40 ha
GSK-KPA-A-201/11 (KPA23971)	Ngastra Nr. 273, në vendin e quajtur “Svinjski Potok”, kullosë e klasës së 2-të, me sipërfaqe prej 0. 05. 30 ha
GSK-KPA-A-202/11 (KPA23970)	Ngastra Nr. 272, në vendin e quajtur “Svinjski Potok”, pemishte e klasës së 4-të, me sipërfaqe prej 0. 03. 90 ha
GSK-KPA-A-203/11 (KPA23968)	Ngastra Nr. 250/2, në vendin e quajtur “Svinjski Potok”, arë e klasës së 5-të, me sipërfaqe prej 0. 24. 73 ha
GSK-KPA-A-204/11 (KPA23963)	Ngastra Nr. 244, në vendin e quajtur “Svinjski Potok”, arë e klasës së 5-të, me sipërfaqe prej 0. 47. 19 ha
GSK-KPA-A-205/11 (KPA23960)	Ngastra Nr. 240, në vendin e quajtur “Svinjski Potok”, arë e klasës së 5-të, me sipërfaqe prej 0. 38. 29 ha
GSK-KPA-A-211/11 (KPA23975)	Ngastra Nr. 275 , në vendin e quajtur “Svinjski Potok”, kullosë e klasës së 3-të, me sipërfaqe prej 0.3.85 ha
GSK-KPA-A-212/11 (KPA23965)	Ngastra Nr. 248/2, në vendin e quajtur “Svinjski Potok”, arë e klasës së 5-të, me sipërfaqe prej 0.36.31 ha
GSK-KPA-A-213/11 (KPA23959)	Ngastra Nr. 239 , në vendin e quajtur “Svinjski Potok”, livadh i klasës së 5-të, me sipërfaqe prej 0.57.69 ha
GSK-KPA-A-214/11 (KPA23957)	Ngastra Nr. 238, në vendin e quajtur “Svinjski Potok”, arë e klasës së 5-të, me sipërfaqe prej 0.46.19 ha
GSK-KPA-A-215/11 (KPA23956)	Ngastra Nr. 237 , në vendin e quajtur “Svinjski Potok”, arë e klasës së 5-të, me sipërfaqe prej 0.23.74 ha
GSK-KPA-A-216/11 (KPA23955)	Ngastra Nr. 236 , në vendin e quajtur ”Svinjski Potok”, arë e klasës së 5-të, me sipërfaqe prej 0.9.30 ha
GSK-KPA-A-238/11 (KPA23958)	Ngastra Nr. 271 , në vendin e quajtur ”Svinjski Potok”, kullosë e klasës së 3-të, me sipërfaqe prej 0.0.35 ha

Më vonë gjatë procedurës, paraqitësi i kërkesës ka dorëzuar edhe:

- Deklaratën lidhur me Origjinën e Pronësisë, e datës 4 dhjetor 2007;
- Kontratën e Dhurimit të Palujtshmërisë, VR.nr. 129/71 e datës 5 qershor 1971;
- Kontratën e Shitjes së Palujtshmërisë, VR.nr. 208/83, e datës 4 mars 1983;
- Çertifikatën e Vdekjes së S.N., e lëshuar me 21 janar 2008, Vranjë, Serbi.

Në prill, maj, qershor, korrik, tetor dhe nëntor të vitit 2007 zyrtarët e AKP-ës kanë shkuar në vendet ku pretendohet se ndodheshin ngastrat e kërkuara dhe ka vendosur shenjat që tregojnë se pronat ishin objekt kontesti të kërkesave dhe se palët e interesuara duhet t'i paraqisnin përgjigjet e tyre brenda 30 ditëve. Sipas raporteve të njoftimit pronat ishin gjetur te pa uzurpuara (përveq parceles Nr. 271 objekt kontesti i kërkesës nr. KPA23958).

3 vite më vonë me datë 22 korrik 2010, një njoftim tjetër është bërë, këtë herë përmes publikimit në Gazetën/Listën nr. 5. Publikimi është vendosur në hyrje dhe dalje të fshatit Sadovinë e Çerkezëve, pompën e derivative "Egzona", Komunën e Vitisë, Zyra Kadastrale e Vitisë, Gjykata Komunale e Vitisë dhe në AKP Zyra Regjionale e Gjilan. E njëjta Gazetë në UNHCR, Zyren Regjionale dhe Ombudsperson.

Mbi bazën e Fletës Poseduese Nr. 4 dhe Nr. 134 të dorëzuar, zyrtarët e AKP-ës kanë gjetur Fletën Poseduese Nr. 4 të lëshuar në prill, korrik dhe shtator të vitit 2007, dhe Fletën Poseduese Nr. 134, lëshuar me 16 prill 2007 të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, Komuna e Vitisë, Zona Kadastrale e Sadovinës së Çerkezëve. Mbi bazën e dokumenteve është treguar se të gjitha parcelat e kërkuara janë pronësi e paraqitësit të kërkesës. Përveq kësaj, AKP-ja ka verifikuar në mënyrë pozitive dhe leternjoftimin e paraqitësit të kërkesës.

Raporti i njoftimit dhe i konfirmimit i Sekretarisë Ekzekutive të AKP-ës, i datës 22 qershor 2012 konstaton se njoftimi i ngastrave kadastrale të kërkuara dhe të regjistruara në Fletën Poseduese nr. 4 dhe 134, Komuna e Vitisë, Zona Kadastrale e Sadovinës së Çerkezëve, është bërë vetëm përmes publikimit në Gazetën/Listën e cila nuk përmban të gjitha elementet gjeodezike të nevojshme të cilat do të shërbënin si kushte për një njoftim të rregullt dhe të plotë. Prandaj, njoftimi përmes publikimit nuk është bërë duke i vendosur afishet/tabelat në paluajshmëritë që janë subjekt i kërkesës ashtu siç parashikohet me dispozitat e nenit 10 paragrafi 1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079. Me këtë dispozitë ligjore

parashikohet se Sekretaria Ekzekutive e njofton dhe i dërgon kopjen kërkesës çdo personi i cili aktualisht ushtron apo pretendon se ka të drejtë në pronën e cila është obje i kërkesës.

Ky lloj njoftimi dhe publikimi me shpërndarjen e Gazetës/Listës nr. 5 së AKP-ës në pompen e derivateve “Egzona” dhe në vende tjera të Komunës së Vitisë nuk mund të konsiderohet si valid dhe në pajtim me këto dispozita ligjore. Prandaj nuk mund të konsiderohet personi me interes ligjor në këto kërkesa ka mar njoftim të rregullt lidhur me kërkesat e kërkuarit.

Me datë 10 tetor 2007 Sekretaria Ekzekutive e njofton Komisionin e kërkesave pronësore se humbja e posedimit mbi pronat e kërkuara ka ndodhur me 13 gusht 1999.

Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KKPK) në lidhje me pronat e kërkuara me vendimet e saja KPCC/D/A/92/2010 dhe KPCC/D/A/97/2010 ka konfirmuar pronësinë e D.N. në pronat e kërkuara dhe ka urdhëruar që të njejtin ti jepen në posedim këto palujtshmëri. Me të njejtin vendim është vendosur që pala përgjegjëse ose ndonjë person tjetër që ka uzurpuar pronën ta liroj atë mbrenda afatit prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhëri, në të kundërtën ata do të dëbohen nga ato.

Vendimi i është dorëzuar ankuesit me 13 prill dhe 13 maj 2011.

Me 9, 30 nëntor dhe 14 dhjetor 2011, ankuesi ka paraqitur ankesat në Gjykatën Supreme, duke kundërshtuar vendimin e KKPK-së për shkaktë vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke ia bashkangjitur ankesës Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Viti C.nr. 199/2009, të datës 8 janar 2010, si dhe aktvendimin e Zyrës Komunale Kadastrale në Viti Nr. 426/21 të datës 9 nëntor 2011.

Me datë 12 dhe 22 nëntor 2011, paraqitësi i kërkesës (më tutje në tekst” “pala përgjegjëse në ankesë”) në përgjigjen e tij në ankesa ka deklaruar se ankuesi sipas dispozitës së nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullorës së UNMIK-ut 2006/50, nuk ka marrë pjesë në procedurën e zhvilluar pranë AKP-ës në afatin e paraparë prej 30 ditësh, pas datës së publikimit dhe njoftimit, prandaj edhe i njejtin nuk ka qenë palë në këtë procedurë, dhe me këtë ai as edhe nuk ka pasur të drejtë në paraqitjen e ankesave kundër këtij vendimi. Më tutje pala përgjegjëse në ankesë i ka propozuar Gjykatës Supreme që ankesat e tillë ta hedhë si të papranueshme.

Për më shumë pala përgjegjëse në ankesë thekson se Gjykata Komunale në Viti me aktgjykimin C.nr.199/2009, i datës 8 janar 2010 është marrë në kundërshtim me dispozitat e nenit 3 paragrafi 1 të Rregullorës së UNMIK-ut 2006/50, sepse lidhur me këto ngastra kadastrale ai në AKP ka paraqitur kërkesat, prandaj kjo gjykatë nuk ka pasur jurisdiksion për të vendosur në të njejtat.

Kjo edhe për faktin se procedura lidhur me aktgjykimin C.nr.199/2009 të datës 8 janar 2010 ka filluar në vitin 2009, ndërkaq që Rregullorja 2006/50 ka filluar të aplikohet në vitin 2006. Nuk është fakt kontestues se me datën 17 shkurt 2001 është lidhur kontrata e shitjes që për objekt kishte ngastrat që janë objekt i kërkesave të paraqitura, por që kjo kontratë nuk është realizuar tërësisht, sepse E.X. si blerës ka paguar shumën prej 100, 000. 00 DM dhe ka mbetur pa paguar shumën prej 114, 472. 00 DM, që rezulton edhe nga deftesa e nënshkruar nga shitësi dhe blerësi.

Përfundimisht, pala përgjegjëse në ankesë thekson se kontrata e sipërtheksuar është idhur me E.X., ndërkaq që aktgjykimi kontestues është në favorin e S.X., është marrë pa thirrjen dhe pa prezencën e tij në procedurë, ndonëse adresa e tij ka qenë e njohur për ankuesin. Prandaj, për këto shkaqe dhe arsye ai i propozon Gjykatës Supreme që të hedhë si të papranueshme ose t'i refuzoj si të pabazuar ankesat e tij.

Gjykata Supreme i ka bashkuar lëndët.

Arsyetim ligjor:

Bashkimi i ankesave:

Neni 13.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079 mbi Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme Private duke përfshirë Pronën Bujqësore dhe atë Komerciale, përcakton se Gjykata Supreme mund të vendosë për ankesat e bashkuara apo të shkriura, kur për bashkimin apo shkrirjen e kërkesave është vendosur nga Komisioni, në pajtim me nenin 11.3 (a) të kësaj Rregulloreje. Ky nen i mundëson Komisionit që të marrë në konsideratë bashkimin ose shkrirjen e kërkesave me qëllim të shqyrtimit dhe marrjes së vendimeve kur ekzistojnë çështje të përbashkëta ligjore dhe të provave.

Dispozitat e Ligjit mbi Procedurën Civile të cilat janë të zbatueshme në procedurën e apelit pranë Gjykatës Supreme sipas nenit 12.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, pastaj ato të nenit 408.1, në lidhje me nenin 193 të Ligjit Nr. 03/L006 mbi Procedurën Kontestimore, parshohin mundësinë e bashkimit me aktvendim të të gjitha padive nëse ky bashkim i kontribon efikasitetit të procedurës.

Në tekstin e ankesave të parashtruara nga ana e ankuesit, Gjykata Supreme konstaton se përveq numrit të ndryshëm të lëndës për të cilën saktësisht ushtrohet ankesa përkatëse, e gjitha baza faktike dhe ligjore, si dhe çështja e provave është plotësisht e njëjtë në të 15 (pesëbëdhjetë) lëndët. Vetëm parcelat, objekte të së drejtës pronësore, të cilat pretendohen në secilën kërkesë janë të ndryshme. Ankesat bazohen në deklaratën e njëjtë

sqaruese dhe në dokumentacionin e njejtë. Për më shumë edhe arsyetimi ligjor i dhënë nga ana e Komisionit për kërkesat është i njejtë.

Ankesat e regjistruara nën numrat GSK-KPA-A-198/11 deri 205/11, GSK-KPA-A-211/11 deri GSK-KPA-A-216/11, dhe GSK-KPA-A-238/11 janë bashkuar në një lëndë të vetme të regjistruar nën numrin GSK-KPA-A-198/11.

Pranueshmëria e ankesave:

Bazuar në dispozitat ligjore të Nenit 194 të LCP-ës, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të ankesave të ushtruara Gjykata Supreme e Kosovës gjen, si vijon:

Ankesat janë të pranueshme ngase janë paraqitur mbrenda afatit ligjor sipas nenit 21.1 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, ku parashikohet që pala mund të paraqesë ankesë kundër vendimit të Komisionit brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve për vendimin. Përderisa për palën ankuese nuk ka prova se kur i është dorëzuar vendimi ankimor, ndërkaq ankesat ai i ka paraqitur 9, 30 nëntor dhe 14 dhjetor 2011, ndërkaq njoftimi përmes publikimit nuk është bërë sipas nenit 10.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079 atëherë sipas vlerësimit të kësaj gjykate ankesa është e pranueshme.

Për më tepër ankesa është e pranueshme gjithashtu ngase Sekretaria Ekzekutive e AKP-ës nuk e ka bërë njoftimin dhe publikimin me vendosjen e plakatave në ngastrat kadastrale të kontestuara sipas formës standarde të parashikuara me nenin 10.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr.03/L-079. Prandaj nuk mund të konsiderohet personi me interes ligjor apo ankuesi në këto kërkesa të ketë marr njoftim të rregullt lidhur me kërkesat e kërkuarit vetëm me shpërdarjen e Gazetës/Listës në disa vende të Komusës së Vitisë. Personave me interes ligjor e në këtë rast konkret edhe ankuesit me veprim të kundërligjshëm të organit administrativ të shkallës së parë i ka pamundësuar të merr pjesë shqyrtojë apo të ketë akses në procedurat administrative të këtij organi, gjë paraqet shkelje thelbësore të nenit 182 paragrafi 2 nënparagrafi (i) të LPK-ës.

Me datë 17 shkurt 2001, ankuesi dhe pala përgjegjëse në ankesë kanë lidhur kontratën e shitëblerjes së paluajshmërive që janë objek i këtyre kërkesave si dhe nënshkruar dëftesën e të njejtës datë që blerësi – ankuesi për blerjen e këtyre paluajshmërive ka paguar çmimin e shitblerjes në shumë prej 100,000.00 DM dhe ka mbetur borgj në shumë prej 114.472.00 DM.

Nga formulari i kërkesës dhe raporti i përpunimit të kërkesës i datës 10 tetor 2007 mund të konstatohet se pronësia është uzurpuar nga personat e panjohur dhe se nuk janë indentifikuar pala përgjegjëse ose pala me interes ligjor.

Nga kjo gjendje e faktike me pamëdyshje rezulton se vendimi ankimor është marr me shkelje thelbësore nga neni nenet 194 dhe 182 paragrafi 2 dhe subparagrafi (b) të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, dhe për këto shkaqe i njëjti është dashur ex officio të anulohet dhe kërkesat të hedhen për shkak se kërkesat e tilla bien jashtë jurisdiksionit të Komisionit për shqyrtimin e kërkesave pronësore. Kjo pikërisht për arsye se, sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, një paraqitës kërkesë ka ta drejtë në një urdhër nga Komisioni për ri-posedim të pronës nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon jo vetëm të drejtën në pronësore por edhe se ai ose ajo tani nuk është në gjendje t'i ushtrojë ato të drejta pronësore për shkak të rrethanave që lidhen drejtpërdrejtë apo që rezultojnë nga konflikti i armatosur që ndodhi në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

Paraqitësi i kërkesave-pala përgjegjëse në përgjigjen e tij në ankesë konfirmon faktin se ka lidhur kontratën e shitëblerjes (ai përgjegjes së tij në ankesë i ka bashkangjitur kontratën e shitëblerjes dhe vërtetimin e pagesës së pjesërishme të çmimit shitëblerës) me ankuesin në lidhje me ngastrat kadastrale që janë objekt i kërkesave, për çmimin kontraktues 214, 472. 00 DM dhe se ai ka paguar këtë çmim në shumë prej 100,00. 00 DM duke i mbetur borgj në shumë prej 114, 472. 00 DM.

Shitësi - pala përgjegjëse në ankesë ka kërkuar që blerësi-ankuesi ta paguajë këtë çmim por ai ka refuzuar.

Bazuar në kontratën e shitëblerjes së paraqitur me datë 17 shkurt 2011 dhe dëftesën e pagesë së pjesërishme të kësajë kontrate të së njëjtës datë, mund të përfundohet se nuk ka prova juridikisht të vlefshme se ngastrat kadastrale janë humbur, dhe e drejta pronësore ndaj tyre nuk mund të ushtrohet për shkak të rrethanave që ndërlihen drejtpërdrejtë apo që rezultojnë nga konflikti i armatosur 1998/1999 në Kosovë.

Kontratrat janë shprehje e autonomisë së vullnetit të ndërsjellë të shitësit dhe blerësit përderisa nuk vërtetohet e kundërta me prova juridisht të vlefshme dhe nga gjykata kompetente. Pra, nëse kontrata është e lidhur mbi bazën e vullnetit të lirë të palës si e tillë ajo është valide dhe prodhon efekte ligjore inter-partes.

Prandaj, në bazë të gjithë asaj që u tha më lartë, KKPK-ja dhe Gjykata Supreme nuk ka jurisdiksion në vendimarrje dhe se është e kufizuar vetëm në shqyrtimin e kërkesave që kanë të bëjnë me të drejtat pronësore të cilat janë humbur si rezultat i konfliktit të armatosur që ka ndodhë midis 27 shkurtit 1998 dhe qershorit

1999 në Kosovë. Por, pala përgjegjëse në ankesë si person me interes ligjor mund t'i adresohet gjykatave të rregullta.

Objekt i shqyrtimit dhe vlerësimit të Gjykatës Supreme ishin pretendimet e palës përgjegjëse në ankesë se ankuesi nuk mund ta ketë cilësinë e palës për të paraqitur ankesë sepse ai nuk ka marr pjesë në procedurën administrative të Sekretariatit Ekzekutiv të AKP-ës në afatin prej 30 ditësh nga dita e njoftimit të këtijë Sekretariati të parashikuar me dispozitën e nenit 10.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr.03/L-079. Prandaj propozon që ankesa të hedhet si e papranueshme. Këto pretendime Gjykata Supreme i vlerëson si të papranueshme të pabazuara dhe rrjedhimisht të kundërligjësme. Kjo ngase njoftimi nuk është bërë në mënyrën e duhur.

Në përputhshmëri me dispozitat ligjore Sekretariati Ekzekutiv i AKP-ës është i obliguar që të njoftoj dhe dërgoj një kopje të kërkesës së paraqitur te secili person i cili ushtron ose pretendon që ka të drejtë pronësore në palujtshmërinë e kërkuar. Njoftimi përmes publikimit dhe shpërndarjes së Gazetës/Listës në pompen e derivative “Egzona” dhe në vendet e tjera mbrenda territorit të Komunës së Vitisë nuk mund të konsiderohet valid dhe në përputhje me dispozitat ligjore. Ky është shkaku se pse nuk mund të konkludohet se së ankuesi ose personi me ineteres juridik është njoftuar drejtë. Por mbi të gjitha kërkesat/ankesat nuk kanë qenë mbrenda jurisdikcionit të Komisionit/Gjykatës Supreme dhe për këtë shkak është dashur të hudhen poshtë.

Këshillë ligjore:

Në përputhje me Nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Elka Ermenova, Gjyqtare e EULEX-it

Urs Nuffer, Referent i EULEX-it